

Tema e Fexhrit (Imsakut) dhe e Shafakut (Jacise)

Me poshte po ju japim nje shpjegim te shkurter mbi kohet e Imsakut dhe te Jacise te cilat ne tabelen e Koheve Te Faljes jane te shenuara me “(*) shenjen e yllit”.

Per kohet e namazit ose te agjerimit te cilat nuk shfaqen , dijetaret e Islamit na e kane paraqitur shume qarte se cilat kohe duhet te perdoren dhe ne cmenyre perdoren ato. Ngaqe neper veprat e tyre kane paraqitur shume qarte se cilat menyra llogaritjeje duhet te perdoren, perfshi ketu edhe llogaritjet per polet e Jugut dhe tw Veriut, dhe keto llogaritje jane aplikuar gjithmone prej 1400 vjetesh, eshte e domosdoshme qe te perdorim keto llogaritje.

Astronomet e Islamit ne librat e “**Astronomise**”, “**Hej’et**” dhe “**Kosmografia**” e kane shpjeguar shume qarte me terma fetare dhe te astronmise kete teme, pra temen e llogaritjes se kohes se Fexhrit (Imsakut) dhe e Shafakut (Jacise) per qytetet te cilat ndodhen ne Veri te paralelit 47 grade e 33 minuta. Keto qytete ndryshe quhen edhe “**Qytetet qe Ndodhen ne Paralelin e Veriut**”. Qytetet qe bejne pjese ne kete grup jane qytetet te cilat ndodhen ne Veri te Evropes, Rusise, Kanadase ose Amerikes. Astronomet e Islamit kane dhene detaje teper qe qarta ne lidhje me llogaritjen e koheve te faljes ne keto vende.

Per keto qytete perdorimi i,

- (**akrab-I lejali**) pra, perdorimi i kohes se imsakut qe dallohet per here te fundit dhe koha e jacise se po asaj dite, deri sa te filloje te shfaqet perseri imsaku, ose,
- (**akrab-I bilad**) pra, perdorimi vendeve te afert ku shfaqen kohet e faljes, pra te perdoren ato kohe te cilat llogariten ne vendet e aferta,

Citohet qarte ne Ibni **Abidin** dhe ne librat e dijetareve te kater meth’hebeve te vertete. Kohet qe llogariten me keto dy metoda, jane afersisht te njejta me njera tjetren.

Ne vendet ku nuk shfaqen kohet e imsakut dhe jacise, kohet e llogaritura sipas (**akrab-I lejali**) pra, perdorimi i kohes se imsakut qe dallohet per here te fundit dhe koha e jacise se po asaj dite, deri sa te filloje te shfaqet perseri imsaku, ose, **akrab-I bilad**) pra, perdorimi vendeve te afert ku shfaqen kohet e faljes, pra te perdoren ato kohe te cilat llogariten ne vendet e aferta, jane njelloj si kohet e zakonshme te imsakut dhe jacis prandaj edhe ne keto vende ne kohen e imsakut dhe jacise te percaktuar sipas ketyre llogaritjeve eshte e nevojshme qe te bejme nijet dhe te falim namazin dhe te kryejme agjerimin.

Per shembull:

Astronomi i madh i Islamit, I nderuari Ahmed Zija, ne librin e tij (Ilm-I hej'et) shkruan: **(Duke ju afruar poleve, fillimi I koheve te sabahut dhe jacise, pra kohet e fexhrit (Imsak) dhe shafakut (Jaci), largohen nga koha e lindjes dhe e perendimit te diellit. Pra kohet e fillimit te namazit te sabahut dhe jacise afrohen me njera tjetren. Duke u larguar nga Ekuatori, kohet e faljes se cdo shteti ndryshojne ne varesi te lartesis se paralelit [Latitude= ϕ] dhe pjerresise se diellit [Deklinacioni= δ], pra ne varesi te muajve dhe te diteve.)** Ne vendet ku grada e paralelit eshte me e madhe se (90-deklinacion), fenmeni I dites dhe I nates nuk ndodh fare. Ne vendet ku shuma e paraleleve (nuk I ploteson 90 grade) eshte me e vogel se (deklinacion+19), pra kur shuma e paraleleve dhe e pjerresise se dielli eshte (90-19=71) ose me e madhe, me nje shprehje tjetër kur pjerresia e diellit eshte me shume se pese grade, fexhri (sabahu) fillon pa kaluar shafaku (jacia).

Nje tjetër astronom I Islamit, I nderuari Hasib ne librin e tij (**Kozmografia**) shkruan: **“(Ne vendet qe ndodhen mbi paralelin 66° 33' ndodhin dite pa nete dhe nete pa dite. Nese duke u nisur nga paraleli 66° 33' ne drejtim te Ekuatorit ne largesine 19° vizatohet nje rreth parallel, ne vendet, paralelet e te cileve nodhen midis ketyre dy rratheve, ndodhin dukurite e Fexhrit (imsak) dhe Shafakut (jaci). Ne vendet ku shuma e paraleleve (nuk I ploteson 90 grade) eshte me e vogel se (deklinacion+19), pra kur shuma e paraleleve dhe e pjerresise se dielli eshte 90-19=71 ose me e madhe, fexhri (sabahu) fillon pa kaluar shafaku (jacia).”** (ngaqe (66° 33' - 19° 00' = 47° 33', ne vendet qe ndodhen mbi paralelin 47° 33' (sabahu) fillon pa kaluar shafaku (jacia) “Pa u zhdukur ngjyra e kuqe ne vendin ku perendon Dielli”)

Pra nga kjo kuptojme se Fexhri (imsaku) dhe Shafaku (jacia) verehen ne ato vende qe ndodhen na paraleli 47° 33' e deri tek 66° 33' (66° 33' i perfshire). Ne vendet qe ndodhen midis ketyre paraleleve ne ditet perpara dhe pas 22 Qershorit, pra ne muajt e veres Fexhri (imsaku) fillon pa kaluar shafaku (jacia) “Pa u zhdukur ngjyra e kuqe ne vendin ku perendon Dielli, pra kohet e imsakut dhe jacise nuk fillojne (nuk perjetohet erresira e nates).Dijetaret e Ehl-i synnetit kane thene: **“Ne rastet kur keto kohe nuk fillojne, eshte mire qe te falemi ne kohet e dites se fundit kur jane verejtur keto kohe.”** Per kete arsye perpara koheve te tilla ne tabelen e koheve te faljes eshte vendosur “Shenja e yllit” dhe poshe eshte vendosur perseri **“Shenja e yllit” me shpjegimin “Kohet e Imsakut dhe Jacise, jane kohet e dites se fundit kur eshte shfaqur imsaku.”**

Ne kete table sa me lart te ndodhet vendi siper paralelit 47° 33' aq me I madh eshte numri I diteve ku kohet e imsakut dhe jacise jane me “Shenjen e yllit”, pra sa me shume ti afrohem poleve aq me shume shtohet numri I ketyre diteve, pra diteve te veres para dhe pas 22 Qershorit. Nese ne nje vend nuk ka kohe imsaku, nuk ka as kohe jacie; pra nese nuk shfaqet koha e imsakut nuk shfaqet as koha e jacise. Ne vende te tilla per imsakun dhe jacinë perdoren kohet e dites se fundit kur eshte shfaqur imsaku, dërsia imsaku te filloje te shfaqet perseri.

Ne ditet kur nuk shfaqet “Koha e Imsakut”, koha e imsakut e shenuar me “Shenjen e yllit” I perket dites se fundit kur eshte shfaqur imsaku, dhe eshte njelloj dhe perdoret si te jete imsaku I asaj dite. E njejta gje vlen edhe per namazin e jacise.

Kohet e imsakut dhe jacise, te shenuara me “Shenjen e yllit” jane njelloj si kohet e “**Imsakut**” dhe “**Jacise**” te diteve te tjera, prandaj ashtu sic bejme nijet dhe falim namazin dhe agjerojme ne ditet normale, po ashtu eshte e nevojshme qe te falemi dhe te agjerojme edhe ne keto kohe.

Megjithese sipas meth’hebit Hanefi, koha eshte edhe kushti edhe shkaku I namazit, kur nuk eshte shkaku, pra kur nuk futet koha ai namaz nuk eshte farz dhe nuk falet pa u futur koha, **SIPAS DISA DIJETAREVE, EDHE NE SHTETET KU NETET JANE TE SHKURTRA DHE FEXHRI (IMSAKU) FILLON PERPARA SE TE MBAROJE SHAFAKU (JACIA), ESHT E FARZ QE TE FALESH EDHE NAMAZIN E SABAHUT EDHE ATE TE JACISE.**

Per kete arsye ne rastet kur kohet e ketyre dy namazeve nuk shfaqen, eshte mire qe keto namaze te fallen ne kohen e dites se fundit kur jane shfaqur. Ngaqe disa dijetare kane thene: **NGAQE NEPER HADITHE SHERIF URDHEROHET FALJA E PESE NAMAZEVE NE DITE DHE PERCAKTOHET QE NUMRI I NAMAZEVE NE NJE DITE ESHT E PESE, EDHE NE VENDET KU NETET JANE TE SHKURTERA DHE FEXHRI (IMSAKU) FILLON PERPARA SE TE MBAROJE SHAFAKU (JACIA) ESHT E FARZ TE FALEN NAMAZET E SABAHUT DHE JACISE,** edhe ne ditet kur imsaku dhe jacia jane shenuar me “Shenjen e yllit” duhet vepruas si ne ditet normale; kjo eshte e pershtatjshe me thenjet e te gjith e dijetareve dhe eshte me e sigurte. Te gjith e muslimanet duhet te veprojne me siguri ne te gjith a ibadetet e tyre.